




Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost/Kosovo Academy for Public Safety

Fakulteti i Sigurisë Publike
Fakultet Javne Bezbednosti/Faculty of Public Safety

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë
Odeljenje za osiguranje kvaliteta/Division for Quality Assurance

Raport i përgjithshëm i të diplomuarve në arsimin e lartë



Lista e shkurtesave

IAL: Institucion i Arsimit të Lartë

AKSP: Akademia e Kosovës për Siguri Publike

FSP: Fakulteti i Sigurisë Publike

ISP: Institucionet e Sigurisë Publike

PK: Policia e Kosovës

IPK: Inspektorati Policor i Kosovës

AME: Agjencia e Menaxhimit Emergjent

SHKK: Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK: Shërbimi Sprovues i Kosovës

DK: Doganat e Kosovës

DSC: Divizioni për Sigurim të Cilësisë

SMU: Sistemi i Menaxhimit Universitar

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	2
Hyrja	4
Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC	5
Realizimi i pyetësorit	5
Të gjeturat e pyetësorit.....	6
Analiza e të gjeturave.....	8
Kënaqshmëria e përgjithshme	8
Ndikimi i studimeve në karrierë	9
Përputhja e planprogramit me tregun e punës.....	10
Zhvillimi i aftësive analitike	11
Lidhja me institucionin dhe rrjetin Alumni	12
Perceptimi institucional	13
Rekomandimet	14

Hyrja

AKSP është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike. Në kuadër të strukturës organizative të Akademisë funksionon Fakulteti i Sigurisë Publike, i cili zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike. Fakulteti ofron programe studimi për të gjitha institucionet e sigurisë publike, përkatësisht:

- *Policinë e Kosovës;*
- *Inspektoratin Policor të Kosovës;*
- *Shërbimin Korrektues;*
- *Shërbimin Sprovues;*
- *Doganën e Kosovës;*
- *Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;*

Arsimi i lartë në AKSP - Krahas aprovimit të Ligjit të AKSP-së në dhjetor të vitit 2011, Komisioni Evropian ka aprovuar dhe financuar Projektin e Binjakëzimit me titull: “Përmirësimi i arsimit në sektorët e sigurisë dhe rendit publik” implementuar gjatë periudhës 2012 – 2014 nga Finlanda dhe Estonia. Përmes projektit të binjakëzimit u bë e mundur themelimi i Fakulteti i Sigurisë Publike gjegjësisht Arsimit të Lartë në fushën e sigurisë publike për të gjithë zbatuesit e ligjit, në përputhje me procesin e Bolonjes, përkatësisht me standardet evropiane.

Sigurimi i cilësisë në AKSP - është pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm për të gjitha proceset dhe aktivitetet në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Sistemi i zbatuar i cilësisë jep një pasqyrë të parimeve të menaxhimit të cilësisë në AKSP-ë dhe tregon se si ato parime mund ta përbëjnë bazën për përmirësimin e performancës dhe përsosjes organizative.

Parimi i përmirësimit të vazhdueshëm është parimi kryesor dhe pjesë e vizionit të Akademisë. Në këtë frymë janë krijuar pyetësor në cilësinë e mekanizmave matës dhe përmirësues në fushën e arsimit të lartë duke e vendosur studentin në qendër.

Në muajin tetor 2024, në vazhden e aktiviteteve për të përmirësuar cilësinë brenda AKSP, DSC-ja ka realizuar pyetësorin elektronik me të diplomuarit e FSP-së, si një proces tashmë i zakonshëm vjetor. I gjithë procesi ka qenë transparent, dhe të gjithë pyetësorët kanë qenë anonim duke respektuar kështu dinjitetin e secilit respondent dhe duke ruajtur kredibilitetin dhe prestigjin e institucionit.

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë –DSC

Divizioni për Sigurimin e Cilësisë është një divizioni i cili në veprim është i pavarur dhe funksionon nën Zyrën e Drejtorit të përgjithshëm të AKSP-së dhe raporton direkt tek drejtori i përgjithshëm i AKSP-së. DSC angazhohet në rritjen e cilësisë në AKSP duke zbatuar të gjitha politikat institucionale dhe instrumentet matës të cilësisë të aprovuar në doracakun e cilësisë i cili rishikohet në baza të rregullta periodike komfor ndryshimeve të reja dhe azhurnimeve të reja akterët relevant për të cilat DSC ofron raportet vlerësuese. DSC harton raporte që përmbajnë gjetje dhe rekomandime për secilin pyetësor të realizuar të cilët i dërgon te Drejtori i përgjithshëm i AKSP si dhe tek Dekani i FSP në raste të arsimit të lartë me qëllim të planifikimit të zhvillimit të stafit akademik dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Realizimi i pyetësorit

Për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve studimore dhe për të vlerësuar në mënyrë objektive rezultatet e arritura në arsimin e lartë, Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka hartuar dhe ndërmarrë realizimin e një pyetësori të posaçëm për të diplomuarit. Ky pyetësor synon të mbledhë mendime, komente dhe përvoja lidhur me nivelin akademik, përgatitjen profesionale, kompetencat e fituara gjatë studimeve si dhe përshtatshmërinë e tyre në tregun e punës. Përmes këtij instrumenti, AKSP synon të identifikojë pikat e forta të programeve, si dhe fushat ku kërkohet përmirësim, duke mundësuar adaptimin e kurrikulave dhe forcimin e lidhjes ndërmjet arsimit dhe praktikës profesionale. Të dhënat e mbledhura do të analizohen në mënyrë sistematike dhe do të përdoren si dëshmi në proceset e sigurimit të cilësisë, vetëvlerësimit dhe akreditimit institucional.

Të gjeturat e pyetësorit

Objekti: Bazuar në objektivin primar të përmirësimit të cilësisë, objektivet sekondare janë matja e nivelit të kënaqësisë së të diplomuarve me programin e studimeve dhe përvojën akademike, të analizojë ndikimin e diplomimit në punësim dhe zhvillimin e karrierës profesionale, të identifikojë nevojat për ndryshime ose përmirësime në kurrikulë, trajnim praktik dhe mbështetje institucionale, të grumbullojë sugjerime konkrete nga Alumni për të rritur cilësinë e programeve të studimit dhe përputhjen me tregun e punës dhe të krijojë një bazë të dhënash për bashkëpunim të mëtejshëm me të diplomuarit përmes rrjetit Alumni dhe aktiviteteve të përbashkëta.


Qëllimi: Qëllimi i këtij pyetësi për të diplomuarit e Fakultetit të Sigurisë Publike në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike është të mbledhë informata mbi përvojën e studentëve gjatë studimeve dhe pas diplomimit, të vlerësojë ndikimin e programit të studimeve në zhvillimin profesional dhe punësimin e tyre, të identifikojë pikat e forta dhe dobësitë e programeve akademike dhe trajnimeve praktike, të sigurojë të dhëna për përputhshmërinë e njohurive dhe aftësive të fituara me kërkesat e tregut të punës, të mbështesë përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, infrastrukturës dhe programeve akademike në të ardhmen dhe të forcojë lidhjen midis Fakultetit dhe të diplomuarve përmes rrjetit të Alumni-t.

Kategorizimi i vlerësimit sipas % së fituar, zëbërthyer në notë vlerësimi

Nuk pajtohem aspak	0%-20%	nota e vlerësimit 1	Sqarim: Nota e vlerësimit 5 (pesë) përfaqëson vlerësim maksimal, ndërsa nota e vlerësimit 1 (një) përfaqëson vlerësimin minimal.
Nuk pajtohem	21%-40%	nota e vlerësimit 2	
Neutral	41%-60%	nota e vlerësimit 3	
Pajtohem	61%-80%	nota e vlerësimit 4	
Pajtohem plotësisht	81%-100%	nota e vlerësimit 5	

Nga vlerësimet e pranuar, kemi këto të dhëna si në vijim:

Nuk pajtohem aspak	6	4.5%
Nuk pajtohem	15	11.4%
Neutral	33	25.0%
Pajtohem	53	40.2%
Pajtohem plotësisht	25	18.9%
total përgjigje të pranuar	132	
Mesatarja e kënaqshmërisë	71.5%	
Nota e përgjithshme	3.6	




ANALIZA E VLERAVE NUMERIKE TË FITUARA

Pyetet e pyetësorit		Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotesisht	mesatarja e kënaqshmërisë	nota e vlerësimit
Vlerësimi i te diplomuarve	<u>Studimet kanë avancuar njohuritë e mija për karrierën time aktuale</u>	0.0%	9.1%	0.0%	54.5%	36.4%	83.6%	4.2
	<u>Studimet kanë avancuar aftësitë dhe njohuritë e reja në mënyrë të pavarur</u>	0.0%	9.1%	0.0%	54.5%	36.4%	83.6%	4.2
	<u>Unë kam arritur të aplikoj shkathtësitë dhe njohuritë e fituara në Institucionin ku veproj</u>	0.0%	9.1%	9.1%	63.6%	18.2%	78.2%	3.9
	<u>Studimet kanë hapur mundësinë për zhvillim të karrierës pranë Institucionit ku punoj</u>	0.0%	27.3%	54.5%	18.2%	0.0%	58.2%	2.9
	<u>Plan-programi i studimeve është në përputhje me kërkesat dhe nevojat në vendin e punës</u>	0.0%	18.2%	36.4%	45.5%	0.0%	65.5%	3.3
	<u>Studimet kanë avancuar mendimin analitik dhe logjik në fushën profesionale</u>	0.0%	9.1%	18.2%	36.4%	36.4%	80.0%	4.0
	<u>Gjatë studimeve kam fituar njohuri më të thella në fushën profesionale të aplikueshme</u>	9.1%	0.0%	27.3%	63.6%	0.0%	69.1%	3.5
	<u>Unë përfaqësoj vlerat e FSP / AKSP në punën time</u>	9.1%	0.0%	27.3%	27.3%	36.4%	76.4%	3.8
	<u>Akademia ofron informatën e vazhdueshme për zhvillimet e reja në FSP, me qëllim të avancimit profesional</u>	0.0%	9.1%	54.5%	36.4%	0.0%	65.5%	3.3
	<u>AKSP/FSP ofron mundësinë e mbajtjes së kontakteve me kolegët e studimeve</u>	18.2%	27.3%	27.3%	18.2%	9.1%	54.5%	2.7
	<u>Përshtypjet tuaja për AKSP si Institucion</u>	9.1%	0.0%	36.4%	27.3%	27.3%	72.7%	3.6
	<u>Unë i rekomandoj të tjeret që të studiojnë në FSP</u>	9.1%	18.2%	9.1%	36.4%	27.3%	70.9%	3.5

Analiza e të gjeturave

Kënaqshmëria e përgjithshme

Mesatarja e përgjithshme e kënaqshmërisë prej 71.5% dhe nota mesatare 3.5 dëshmojnë një perceptim pozitiv të programeve të studimit në FSP.



Këto rezultate tregojnë se pjesa më e madhe e të diplomuarve janë të kënaqur me përvojën e studimeve, cilësinë e mësimdhënies dhe mbështetjen institucionale. Në raport me standardet e AKA-së, kjo përqindje përbën një nivel të mirë të performancës akademike, por ende nënkupton nevojë për ngritje drejt nivelit të ekselencës (80%+).


Analiza cilësore e komenteve sugjeron se studentët kanë vlerësuar lartë profesionalizmin e stafit akademik, organizimin e orareve dhe qasjen e drejtë të procesit mësimor.

Megjithatë, një pjesë e të diplomuarve kanë kërkuar më shumë qasje praktike dhe ndërveprim më të madh në procesin e mësimdhënies. Kjo tregon nevojën që Fakulteti të balancojë më mirë komponentin teorik me atë praktik, duke siguruar mjedise të mësimi që nxisin angazhim aktiv dhe zbatim të njohurive në situata reale.

Ndikimi i studimeve në karrierë

Ndikimi i programeve të FSP-së në zhvillimin profesional të të diplomuarve është ndër gjetjet më pozitive të këtij raporti.

Rreth 83.6% e të diplomuarve deklarojnë se studimet kanë kontribuar në rritjen e njohurive dhe aftësive të tyre profesionale, duke i pajisur me kompetenca që janë të aplikueshme në institucionet e sigurisë publike.



Kjo dëshmon për përmbajtje akademike të përshtatur dhe për lidhje të mirë ndërmjet komponentëve teorikë dhe praktikë.


Megjithatë, vetëm 58.2% e të diplomuarve ndjejnë se studimet kanë ndikuar drejtpërdrejt në avancimin e tyre të karrierës brenda institucioneve të punës.

Kjo tregon mungesë të një mekanizmi të integruar të zhvillimit të karrierës pas diplomimit — një element i domosdoshëm në universitetet moderne evropiane.

Në këtë aspekt, Fakulteti duhet të krijojë zyrën e zhvillimit të karrierës dhe mentorimit, e cila do të ofronte udhëzime për përparim profesional dhe përfshirje në rrjetet e punësimit.

Përputhja e planprogramit me tregun e punës

Vetëm 65.5% e të diplomuarve besojnë se programi i studimeve është në përputhje me kërkesat e tregut të punës, çka tregon një hendek të moderuar midis përmbajtjes akademike dhe nevojave profesionale.




Në një treg pune gjithnjë në ndryshim, veçanërisht në sektorin e sigurisë publike, kërkohen kompetenca që përfshijnë menaxhimin e krizave, sigurinë digjitale dhe aftësi të komunikimit ndërinstitutional.

Ky rezultat tregon se Fakulteti duhet të orientojë rishikimin e kurrikulës drejt fleksibilitetit dhe përditësimit të vazhdueshëm. Përfshirja e ekspertëve të praktikës nga institucionet e sigurisë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit në hartimin e moduleve do të përmirësonte ndjeshëm përputhjen e përmbajtjes me realitetin profesional.

Përputhja e kurrikulës nuk duhet të shihet vetëm si përmbajtje teorike, por si proces i mësimi aktiv dhe reflektues, që përgatit studentët për sfida konkrete të punës në fushën e sigurisë.

Zhvillimi i aftësive analitike

Rreth 80% e të diplomuarve vlerësojnë pozitivisht ndikimin e studimeve në zhvillimin e mendimit analitik dhe logjik, duke theksuar rëndësinë e metodave të analizës dhe zgjidhjes së problemeve në fushën e sigurisë publike.




Kjo përqindje e lartë është një tregues pozitiv i cilësisë akademike të programeve, por gjithashtu tregon nevojën që këto aftësi të shoqërohen me komponentë praktikë, përmes simulimeve, ushtrimeve në terren dhe trajnimeve ndërdisiplinore.

Forcimi i lidhjes ndërmjet teorisë dhe praktikës do të mund të rriste më tej aftësitë e aplikueshme të të diplomuarve në situata reale.

Lidhja me institucionin dhe rrjetin Alumni

Një nga sfidat më të theksuara është mungesa e një rrjeti aktiv Alumni. Vetëm 54.5% e të diplomuarve kanë raportuar se kanë mundësi të mbajnë kontakte me kolegët dhe me Akademinë.



Në sistemin modern të arsimit të lartë, rrjetet Alumni janë një komponent kyç për vlerësimin afatgjatë të cilësisë dhe për gjurmimin e karrierës së të diplomuarve.

Një rrjet aktiv Alumni do të shërbente për disa funksione thelbësore:


- mbledhjen e të dhënave mbi punësimin dhe zhvillimin profesional,
- përfshirjen e të diplomuarve në vlerësimin e programeve,
- ndarjen e përvojave për studentët aktualë,
- dhe krijimin e partneriteteve për praktika dhe hulumtime.

Kjo nënvizon mungesën e një strukture të organizuar për mbajtjen e lidhjeve profesionale dhe akademike pas diplomimit. Rrjeti Alumni mund të shërbejë si një platformë e rëndësishme për zhvillimin profesional, për këmbimin e eksperiencave dhe për krijimin e një identiteti të përbashkët institucional.

Një sistem i mirë-menaxhuar Alumni do të forconte ndjeshëm marrëdhënien ndërmjet Akademisë dhe të diplomuarve të saj.

Perceptimi institucional

Përshtypjet e përgjithshme për AKSP janë pozitive, me 80% të të diplomuarve që shprehin kënaqësi për institucionin dhe 70.9% që do ta rekomandonin për studentët e rinj.



Kjo tregon se Akademia gëzon reputacion të mirë, por për ta ruajtur këtë imazh pozitiv, kërkohet angazhim i vazhdueshëm në komunikim publik, në transparencë dhe në promovimin e rezultateve konkrete.

Zhvillimi i programeve ndërkombëtare, pjesëmarrja në projekte rajonale dhe përfshirja e alumnive në evente akademike mund të ndikojnë pozitivisht në përforcimin e imazhit të institucionit.

Rekomandimet

- *Rishikimi i kurrikulës dhe përputhja me tregun e punës - Përfshirja e praktikës profesionale më të theksuar dhe moduleve që pasqyrojnë realitetin në terren. Bashkëpunim më i ngushtë me agjencitë e sigurisë për të përshtatur lëndët sipas kërkesave aktuale.*
- *Zhvillimi i karrierës pas diplomimit -Krijimi i mekanizmave të mentorimit dhe mbështetjes së karrierës përmes zyrës së karrierës dhe partneriteteve me institucionet e sigurisë publike.*
- *Forcimi i rrjetit Alumni - Aktivizimi i rrjetit Alumni përmes takimeve vjetore, platformës digjitale dhe përfshirjes së tyre në vlerësimin e programeve akademike.*
- *Përmirësimi i komunikimit institucional - Zhvillimi i sistemit të komunikimit periodik për të ruajtur kontaktet me të diplomuarit dhe për të ndarë informacion mbi zhvillimet akademike.*
- *Monitorimi i ndikimit të studimeve - Krijimi i një mekanizmi për gjurmimin e punësimit dhe avancimit profesional të të diplomuarve përmes analizave periodike.*
- *Promovimi i rezultateve dhe reputacionit të AKSP - Publikimi i historive të suksesit të alumni-t dhe organizimi i aktiviteteve publike me institucionet partnere për të treguar ndikimin pozitiv të Akademisë.*